

**VENDIM**  
**Nr. 367, datë 30.5.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË HOLLËSISHME DHE INSTITUCIONEVE  
PËRGJEGJËSE PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT, HEDHJES NË TREG,  
PRODHIMIT, IMPORTIMIT APO FUTJES NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË TË QESEVE PLASTIKE MBAJTËSE, SI DHE QESEVE PLASTIKE  
MBAJTËSE TË OXO-DEGRADUESHME APO OXO-BIODEGRADUESHME**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 562, datë 29.7.2022)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e masave të hollësishme për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, me trashësi të mureve të qeses për çdo anë më të vogël se 70 (shtatëdhjetë) mikronë, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 (dhjetë) kilogramë dhe me përmasa më të vogla se 50 (pesëdhjetë) cm gjatësia dhe 24 (njëzet e katër) cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, nga subjektet, sipas parashikimeve të këtij vendimi, nga data 1 qershor 2022.

1.1 Për qëllim të këtij vendimi, fjalët "import" dhe "futja në territorin e Republikës së Shqipërisë" kanë këtë kuptim:

a) "import", vendosja e mallrave në regjimin "çlirim për qarkullim të lirë", në përputhje me përcaktimet e shkronjës "a", të pikës 16, të nenit 6, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;

b) "futje në territorin e Republikës së Shqipërisë", futja e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e neneve 266 e 267, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Përfshihen nga zbatimi i këtij vendimi qeset plastike mbajtëse me trashësi për çdo anë 70 dhe më të madhe se 70 mikronë, me kapacitet mbajtës 10 dhe mbi 10 kilogramë, me përmasa 50 cm gjatësia dhe 24 cm gjerësia dhe më të mëdha se kaq, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve.

3. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (këtu e në vijim "ISHMT") është institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të hollësishme për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike mbajtëse, si më poshtë vijon:

a) Mbikëqyr dhe kontrollon, nëpërmjet kontrollit dokumentar e fizik, subjektet që përdorin dhe/ose i ofrojnë konsumatorit gjatë veprimtarisë tregtare qeset plastike mbajtëse, sipas kritereve ligjore të përcaktuara në këtë vendim, dhe kontrollon ndalimin e përdorimit të qeses plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme;

b) Inspekton me mjete të certifikuara për verifikimin e parametrave të trashësisë së mureve të qeses plastike gjatësinë e gjerësinë e qeses plastike, pa përfshirë pjesën e palosjes, sipas përmasave të përcaktuara në këtë vendim, si dhe verifikon sistemin e shënimit;

c) Kontrollon subjektet për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi sipas pikës 1, për të cilat ka marrë njoftim nga autoriteti doganor sipas parashikimit të shkronjës "c", të pikës 6, të këtij vendimi, dhe njofton autoritetin doganor, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë mbi vendimmarrjen për subjektet dhe mallrat e inspektuara, mbi lejimin apo ndalimin e qeseve plastike për t'u futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

ç) në rastet kur subjektet nuk respektojnë kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, ISHMT-ja ndalon tregtimin e qeseve plastike, procedon me sekuestrimin dhe vendosjen e gjobës,

sipas parashikimeve të pikës 25/1, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

d) njofton në mënyrë të menjëhershme Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave për ruajtjen në ambientet e përcaktuara për këtë qëllim të qeseve plastike të sekuestruara deri në marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit nga ISHMT-ja;

dh) njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për vendimin përfundimtar për subjektet e inspektuara.

4. *Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të hollësishme për ndalimin e prodhimit të qeseve plastike mbajtëse, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij vendimi, si më poshtë vijon:*

a) *Organizon dhe zhvillon fushata ndërgjegjësuere për ndalimin e prodhimit, përdorimit, importit dhe futjes së qeseve plastike mbajtëse, sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në këtë vendim, dhe ndalimin e prodhimit, përdorimit, importit dhe futjes së qesës plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme;*

b) njofton menjëherë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, subjektet e pajisura me leje mjedisore për prodhimin e qeseve plastike, mbi ndalimin e prodhimit të qeseve plastike sipas parashikimeve të ligjit nr. 10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe kërkesave të këtij vendimi;

c) *Inspekton dhe kontrollon subjektet, që prodhojnë qese plastike për përmbushjen e kriterëve të prodhimit, sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe aneksit 1, të këtij vendimi;*

ç) në rastet kur subjektet nuk respektojnë kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, AKM-ja procedon me sekuestrimin dhe vendosjen e gjobës ndaj prodhuesve të qeseve plastike, sipas parashikimeve të pikës 25/1, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

d) merr masa për sigurimin e transportit dhe të ambienteve të përshtatshme për ruajtjen e përkohshme dhe magazinimin e qeseve plastike mbajtëse, qeseve plastike të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, të cilat janë sekuestruar me vendim të strukturave përgjegjëse të inspektimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

dh) merr masa deri në lidhjen e kontratës për vijimin e procedurës për riciklimin e sasisë së qeseve plastike të sekuestruara sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet, kur vendimi për sekuestrimin e qeseve plastike ka marrë formë të prerë sipas legjislacionit në fuqi;

e) krijon regjistër të dhënash, për:

i. masat e marra ndaj subjekteve që prodhojnë qeset plastike mbajtëse dhe qese plastike të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme;

ii. të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për subjektet e inspektuara;

iii. sasisë të sekuestruara të qeseve plastike mbajtëse dhe qese plastike të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme nga subjektet që kryejnë importin, futjen dhe përdorimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike të ndaluara;

iv. *prodhuesit e qeseve plastike mbajtëse si dhe sasinë e qeseve plastike mbajtëse të prodhuara në muaj dhe subjektet të cilat tregtohen për qëllime përdorimi qeset e prodhuara.*

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për pajisjen e strukturës përgjegjëse për inspektimin në mjedis dhe asaj të mbikëqyrjes së tregjeve me mjete të certifikuara për verifikimin e parametrave të trashësisë së mureve të qesës plastike 70 mikronë për çdo anë.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është struktura kryesore përgjegjëse për ndalimin e importimit (çlirim për qarkullim të lirë) apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke marrë masat e hollësishme, si më poshtë vijon:

a) *mbikëqyrjen dhe kontrollin e personave/subjekteve, që importojnë apo fusin në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, me trashësi të mureve të qesës për çdo anë më të vogël se 70 (shtatëdhjetë) mikronë, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 (dhjetë) kilogram dhe me përmasa më të vogla se 50 (pesëdhjetë) cm gjatësia dhe 24 (njëzet e katër) cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve, si dhe ndalimin e importit të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme;*

b) verifikimin e të dhënave që ka deklaruar personi për qeset plastike. Në rast se në deklaratën doganore të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, të sakta, autoriteti doganor kryen verifikimin e parametrave të gjatësisë dhe gjerësisë së qeses plastike sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

c) në rast se autoriteti doganor dyshon se qeset plastike mbajtëse nuk janë konform standardit, njofton menjëherë në rrugë elektronike ISHMT-në:

i. në rast se brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 3, ISHMT-ja konfirmon se qeset plastike përmbushin standardet autoriteti doganor çliron mallin;

ii. në rast se brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 3, ISHMT-ja konfirmon se qeset plastike nuk përmbushin standardet autoriteti doganor kryen procedurat e parashikuara në legjislacionin doganor për mallrat e ndaluara;

ç) në rast konstatimi se parametrat e verifikuar nuk përputhen me ato të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, autoriteti doganor procedon me bllokimin e mallit dhe kryen procedurat e tjera të parashikuara në legjislacionin doganor për mallrat e ndaluara. Njëkohësisht njofton menjëherë në rrugë elektronike dhe zyrtarisht ISHMT-në për vijimin e procedurave të mëtejshme *sipas legjislacionit në fuqi*.

7. Personi/subjekti, që importon qese plastike, objekt të këtij vendimi, deklaron në degët doganore se qeset plastike mbajtëse përmbajnë elementet sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe mban përgjegjësi për mosdeklarim apo deklarim të rremë sipas legjislacionit në fuqi.

8. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe agjencitë rajonale të mjedisit raportojnë periodikisht çdo javë, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, lidhur me:

a) konstatimin e rasteve të shkeljes të kërkesave të këtij vendimi;

b) vendimet përkatëse të marra nga inspektoratet përgjegjëse;

c) sasitë e importuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*8.1. Për zbatimin e këtij vendimi krijohet Task-Forca për qeset plastike mbajtëse. Përbërja, mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohet me urdhër të Kryeministrit.*

9. Shpenzimet për transportin, ruajtjen e përkohshme, magazinimin e qeseve të sekuestruara mbulohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

10. Të ardhurat e krijuara nga procesi i riciklimit të qeseve plastike të sekuestruara klasifikohen si të ardhura dytësore dhe përdoren nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

11. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj